

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarjen e sekretares juridike Naxhis Sharani procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarve Sh. K., M. B. dhe B. M., të tre nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në bashkë kryerje nga nen 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.3271/2015 të datës 20.11.2015, pas mbajtjes të shqyrimit publik në pranin e prokurorit të shtetit Beqë Shala, të akuzuarve dhe të dëmtuarit X. B., me datë 08.06.2016 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. SH. K., nga i ati Sh. dhe nëna Sh. e lindur [REDAKTUE], i lindur me datë [REDAKTUE], në Prizren, ku edhe tani jeton në rrugën “[REDAKTUE]”, nr. [REDAKTUE], ka të kryer shkollën fillore murator, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. M. B., nga i ati X. dhe nëna X. e lindur [REDAKTUE], i lindur me datë [REDAKTUE], në Prizren, ku edhe tani jeton rruga “[REDAKTUE]”, pa numër, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

3. B. M., nga i ati S. dhe nëna N. e lindur [REDAKTUE], i lindur me datë [REDAKTUE], në Prizren, ku edhe tani jeton në rrugën “[REDAKTUE]”, pa numër, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Të pandehurit: Sh. K., M. B. dhe B. M.

Së me datën 18.10.2015, në kohë të pa përcaktuar, në Prizren, në rrugën “[REDAKTUE]” saktësisht në kafiterinë “[REDAKTUE]”, pronë e të dëmtuarit Gj. B., në bashkë veprim ia marrin pasurinë e luajtshme të tjetrit me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në atë mënyrë të pandehurit e shfrytëzojnë mos prezencën e personave, pasi që me forcë e hapin derën hyrëse të lokalit hynë brenda në lokal ku nga aty marrin: 4 pije alkoolike smirnof dhe 3 pija redbull, të njëjtë janë identifikuar në bazë të kamerave të sigurisë në lokal, me të cilat veprime të dëmtuarit i është shkaktuar dëm material,

Kësot dore kanë kryer vepër penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7,41,43 par.1 pika 1.2 dhe 1.3, 45, 46, 73, 74, 75, 76 dhe nenit 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës, të akuzuarve ju shqipton:

Të akuzuarit të pare Sh. [REDAKTUE]:

DËNIM ME BURG

Në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, dhe

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilën shumë i akuzuari është obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, e në rast se i njëjtë nuk mund të paguaj këtë shumë, dhe se dënimini me gjobë nuk mund të ekzekutohet, i njëjtë do të zëvendësohet me dënim me burgim, duke llogaritur nga 1 (një) ditë burg për çdo 20 Euro, respektivisht 15 ditë burg,

Të akuzuarit të dytë M. [REDAKTUE]

DËNIM ME BURG

Në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, dhe

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilën shumë i akuzuari është obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, e në rast se i njëjtë nuk mund të paguaj këtë shumë, dhe se dënimini me gjobë nuk mund të ekzekutohet, i njëjtë do të zëvendësohet me dënim me burgim, duke llogaritur nga 1 (një) ditë burg për çdo 20 Euro, respektivisht 15 ditë burg,

Të akuzuarit të tretë B. [REDAKTUE] M. [REDAKTUE]

DËNIM ME BURG

Në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, në të cilin denim do të llogaritet koha e³ kaluar në paraburgim prej datës 04.11.2015 deri me datën 02.01.2016, dhe

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilën shumë i akuzuari është obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, e në rast se i njëjtë nuk mund të paguaj këtë shumë, dhe se dënimini me gjobë nuk mund të ekzekutohet, i njëjtë do të zëvendësohet

me dënim me burgim, duke llogaritur nga 1 (një) ditë burg për çdo 20 Euro, respektivisht 15 ditë burg,

Obligohen të akuzuarit të paguajnë shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor dhe ate secili veç e veç në shumën prej 50 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishtëmrisë të këtij aktgjykimi, nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.3271/2015 të datës 20.11.2015, kundër të akuzuarve Sh. K., M. B. dhe B. M., të tre nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në bashkë kryerje nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-së.

Prokurori i shtetit Beqë Shala, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: pas dhënies të deklaratës, të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit Xh. B., në dispozitivin e aktakuzës duhet të hiqet shuma prej 300 Euro, ndërsa pjesa tjeter e dispozitivit të aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

Sa i përket aktakuzës mbetëm në tërësi pranë aktakuzës të përmirësuar më lart, dhe ate pas dhënies së deklaratës të dëmtuarit – dëshmitarit. Nga të cekurat në shqyrtimin e sotëm gjyqësor, u vërtetua në tërësi gjendja faktike e përshkruar që në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje e rëndë në bashkë kryerje nga neni 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës, e kjo gjendje faktike është vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, i cili pranim është bërë konform dispozitave ligjore. Andaj propozoj gjykatës që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit, por i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes e vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit të ketë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, sjelljen e tyre gjatë shqyrimit, moshën e të njëjtëve.

I dëmtuari Xh. B., në fjalën e tij përfundimtare deklaron, që si palë e dëmtuar nuk parashtron kërkesë pronësoro juridike ashtu si theksova edhe në fjalën hyrëse dhe në deklaratën time.

I akuzuari i parë Sh. K., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj veprën penale të ricilësuar nga ana e prokurorit të shtetit, pas dëgjimit të dëmtuarit. Pendohem thellë për veprimet e mia, më vije keq për atë që ka ndodhur, i kërkoi falje këtu të dëmtuarit, dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdeshëm dhe do të përbahem nga veprimet e tillë. Konsideroj dhe i propozoj gjykatës që të gjitha këto rrëthana ti merr si rrëthana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin.

I akuzuari i dytë M. B., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj veprën penale të ricilësuar nga ana e prokurorit të shtetit, pas dëgjimit të dëmtuarit. Pendohem thellë për veprimet e mia, më vije keq për atë që ka ndodhur, i kërkoi falje këtu të dëmtuarit, dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdeshëm dhe do të përbahem nga veprimet e tillë.

Konsideroj dhe i propozoj gjykatës që të gjitha këto rrrethana ti merr si rrrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin.

I akuzuari i tretë B. M., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj veprën penale të ricilësuar nga ana e prokurorit të shtetit, pas dëgjimit të dëmtuarit. Pendohem thellë për veprimet e mia, më vije keq për atë që ka ndodhur, i kërkoj falje këtu të dëmtuarit, dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdeshëm dhe do të përbahem nga veprimet e tillë. Konsideroj dhe i propozoj gjykatës që të gjitha këto rrrethana ti merr si rrrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Të pandehurit: Sh. K., M. B. dhe B. M.

Se me datën 18.10.2015, në kohë të pa përcaktuar, në Prizren, në rrugën "██████████" saktësish në kafiterinë "████████", pronë e të dëmtuarit Gj. B., në bashkë veprim ia marrin pasurinë e luajtshme të tjetrit me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në atë mënyrë të pandehurit e shfrytëzojnë mos prezencën e personave, pasi që me forcë e hapin derën hyrëse të lokalit hynë brenda në lokal ku nga aty marrin: 300 Euro, 4 pije alkoolike smirnof dhe 3 pija redbull, të njëjtë janë identifikuar në bazë të kamerave të sigurisë në lokal, me të cilat veprime të dëmtuarit i është shkaktuar dëm material,

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ate të dy të akuzuarit në shqyrtimin kryesor vullnetarisht kanë pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata nuk ka administruar provat e propozuara. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kupuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila ju vihet në barrë dhe që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njofuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenit 248 të KPK-ës dhe faktet që përmban aktakuza në veprime e te akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale dhe ate të veprës penale në bashkë kryerje vjedhje e rëndë nga nenit 327 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës, paraprakisht duke vërtetuar përgjegjësin e tyre penalo juridike për veprën penale që ju vihet në barë.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrrethanat rënduese dhe lehtësuese në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrrethana rënduese, si rrrethana lehtësuese janë marrë faktet se të akuzuarit kanë bashkëpunuar me organet gjyqësore që nga faza fillestare, të njëjtët kanë pranuar fajësinë për veprën penale, janë të moshës së re, pendimet e tyre për veprën penale që e kanë kryer, konform nenit 74 gjykata ka marr parasysh rrrethanat personale dhe karakterin e personave të dënuar, moshën e të njëjtëve, bashkë punimin e përgjithshëm të personave të dënuar me gjykatën, bashkë punimi i personave të dënuar në hetimin në ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga personat e dënuar, sjelljen e personave të dënuar pas kryerjes së veprës penale, andaj gjykata të akuzuarit i shpalli

fajtor dhe ju shqiptoj dënimet dhe ate të akuzuarit të parë Sh. K. dënimin me burgim në kohë zgjatje prej 2 (dy) muaj dhe dënimin me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, të akuzuarit të dytë M. B. dënimin me burgim në kohë zgjatje prej 2 (dy) muaj dhe dënimin me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, dhe të akuzuarit të tretë B. M. dënimin me burgim në kohë zgjatje prej 2 (dy) muaj të cilit do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 04.11.2015 deri me datën 02.01.2016, dhe dënimin me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, duke vërtetuar përgjegjësin e tyre penalo juridike, si dhe duke menduar se dënim i shqiptuar ju përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tyre, peshës dhe pasojave të veprave penale të shkaktuara, duke menduar se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënit që në të ardhmen do të jenë më të kujdeshëm dhe do të përbahen nga veprimet e tillë.

Vendimin mbi shpenzimet e pashallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 450 dhe 451 të KPP-ës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1912/2015 të datës 08.06.2016



Procesmbajtësja
Naxhis Sharani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.